



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.4.2023

Nr: 369

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË SHOQATËS “DIASPORA PËR SHQIPËRINË E LIRË”,
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË GJEORGJISË DHE ORGANIZATËS “IRI” SHQIPËRI,
PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Sot në datën 18.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat me:

KËRKUES: Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”, me seli në Zyrih, Zvicër, dhe me përfaqësues z. Florjan Hackaj,
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Gjeorgjisë, me seli në Tbilisi, Gjeorgji me përfaqësues z. Giorgi Kalandarishvili,
Organizata “IRI”, me degë në Shqipëri me seli në Tiranë dhe me përfaqësues z. John Fluharty.

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve, për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.1.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

V Ë R E J:

Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 9 (nëntë) vëzhgues afatgjatë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5,

Data: 18.4.2023 Nr: 369
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të shoqatës “Diaspora për Shqipërinë e lirë”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë dhe Organizatës “IRI” Shqipëri, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.”

të Kodit Zgjedhor. Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Gjeorgjisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 4 (katër) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. KQZ e Gjeorgjisë është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Organizata “IRI” në Shqipëri i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 7 (shtatë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Organizata “IRI” në Shqipëri është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediae”,

V E N D O S:

1. Akreditimin e 9 (nëntë) vëzhguesve afatgjatë të Shoqatës “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër të KQZ-së së Gjeorgjisë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër të organizatës “IRI” Shqipëri për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 18.4.2023 Nr: 369
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin e kërkesave të shoqatës “Diaspora për Shqipërinë e lirë”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë dhe Organizatës “IRI” Shqipëri, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.”